



Prishtinë: 29.07.2022
Kodi i ZRRE-së: V_1565_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimin e DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_2338_07_22**.

në seancën e mbajtur më datë 29.07.2022 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit **K.M SH.P.K** si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi
- II. **Konsumatori** duhet ti përmbahet kushteve teknike të përcaktuara në Pëlqimin Elektroenergetik nr.13501 të datës 06.12.2018

A r s y e t i m

Konsumatori **K.M SH.P.K**, në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 28.10.2021 ka paraqitur ankesë pranë DMK-së në ZRRE dhe ka kërkuar shqyrtimin e kërkesës për ndërrim të grupit tarifor nga 7/2 në grupin 6/6, pasi konstaton se janë kryer edhe pagesat për Pëlqim Elektroenergetik nr.13501 të datës 06.12.2018.

Me datë 04.10.2018 konsumatori **K.M SH.P.K** bazuar në rregullat dhe procedurat në fuqi ka aplikuar në KEDS për rritje të fuqisë si dhe pëlqim të ri elektroenergetik, po ashtu edhe ndërrimin e grupit tarifor të faturimit nga 7/02 në 6/6.

Provë: Aplikacioni për PEE datë 04.10.2018

Me datë 06.12.2018, KEDS lëshon Pëlqim Elektroenergetik për kompaninë **K.M SH.P.K** dhe cakton kushtet energjetike dhe kushtet teknike dhe po ashtu cakton afatin kohor brenda të cilit është i vlefshëm ky pëlqim elektroenergetik. Sipas PEE nr. 13501 datë 06.12.2018, konsumatori TS e tanishëm Sn=160 kVA Koshare (Sharra) (bashkë pronar) duhet të zëvendësoj me transformatorë të ri Sn=250 kVA si dhe janë përshkruar kushtet e tjera teknike të cilat duhet të zbatohen. Bazuar në skemën një polëshe të dorëzuar se bashku me PEE vërehet se konsumatori ka të instaluar TS me fuqi Sn=160 kVA.

Provë: Pëlqimi Elektroenergetik nr. 13501 i datës 06.12.2018



Me datë 28.12.2018, konsumatori **K.M SH.P.K** ka bere pagesën e Pëlqimit elektroenergjetik te lëshuar nga KEDS me datë 06.12.2018 duke paguar per fuqinë e kërkuar në vlerë 1,775.78€ e ku përfshihet 97.66 kW*15€, shërbimi per kçje ne vlerë 40€ si dhe TVSH.

Provë: Fatura e pagesës se PEE datë 20.12.2018

Me datë 28.12.2018, **K.M SH.P.K** parashtron kërkesë në KEDS, duke kërkuar revidimin e pëlqimit elektroenergjetik me nr.13501 i datës 06.12.2018. Me anë të kësaj kërkesë kompania në fjalë kërkon nga KEDS që të merr shumë seriozisht ndërrimin e grupit tarifor, sepse me ligj nëse del që shpenzimet janë mbi 40-kVA, konstaton se KEDS janë të detyruar të bëjnë ndërrimin e grupit tarifor te cilën e ka përsëritur edhe me datë 04.01.2019.

Provë: Kërkesë e datës 28.12.2018 dhe 04.01.2019

Me datë 27.05.2019 KEDS përmes një shkrese informon konsumatorin se lidhur me kërkesën e tij për revidimin e pëlqimit elektroenergjetik me nr. 13501 të datës 06.12.2018 në fsh.Koshare, KK-Shtime, KEDS ka shqyrtuar kërkesën e palës, e refuzon të njejtën dhe njofton se mbetet në fuqi pëlqimi elektroenergjetik paraprak nr.13501 i datës 06.12.2018.

Provë: Shkresë e datës 27.05.2019

Me datë 16.04.2019 konsumatori ka bere ankese në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kërkuar që ti behet ri shqyrtimi i faturave për periudhat 10/2018 e tutje per shkak te mos faturimit si konsumatorë i grupit tariforë 6/6 por si konsumatorë i grupit tarifor 7/02.

Provë: Ankesa e konsumatorit në KESCO datë 16.04.2019

Me datë 28.05.2019 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij per rishqyrtimin e faturimit e ku thuhet se: sipas analizës së konsumit të përgatitur nga Komisioni për korrigjime të faturave nga KESCO, në bazë të ankesës së konsumatorit, bëhet analiza e rrjedhave energjetike marr nga AMR te konsumatori për vitet 2015, 2016, 2017, 2018 dhe pjesa deri 04/2019, ku konstatohet se njësia matëse ka funksionuar në rregull dhe të dhënat bazike janë reale të regjistruara sipas konsumit dhe kërkesave të konsumatorit **K.M SH.P.K**. Sipas rrjedhave në CRMS shihet se konsumatori ka një konsum me rrjedhshmëri të ndryshme me rritje graduale nëpër vite si dhe është prezantuar përmes tabelës si dhe qe konsumatori per vite ka rritur fuqinë e angazhuar ne mënyrë rapide pa e njoftuar KEDS-in e qe kjo është ne kundërshtim me ligjet, rregullat dhe kodet teknike ne fuqi.

Provë: Komisioni per Korrigjime te faturave

Me datë 03.11.2020 punëtorët e autorizuar të KEDS-it per kontrollimin e Grupeve matëse kanë inspektuar piken matëse te konsumatorit ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve te GM nr. 40239908 ku TL=23455.661 kWh dhe TU=2411,247 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=7946,380 kVAR dhe TU=167,510 kVAR, gjendja e maksigrafit TL=5,4058 si dhe konstanta C=40. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar po ashtu se behet ndërrimi i TMRR nga 100/5A ne 200/5A andaj edhe ndërrohet konstantja nga C=20 ne C=40 si dhe qe duhet te behet ndërrimi i kategorisë se konsumatorit nga 7/02 ne 6/6.

Provë: Raporti mbi kontrollimin-pranimin e grupit matës nr.0210709 datë 03.11.2020



Konsumatori ka ofruar kontratën për furnizim me energji elektrike për konsumatorët jo shtëpiak, me grup tarifor 7/02- komercial 0.4 kV, Kat 2, M2T/7 e lidhur ndërmjet Kompanisë për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike dhe konsumatorit **K.M SH.P.K**, me të cilën rregullohen kushtet e furnizimit, të drejtat dhe obligimet e ndërsjella, faturimi i energjisë së konsumuar, ndërprerja e furnizimit me energji dhe dispozita të tjera në lidhje me shkëputjen e kontratës.

Provë: Kontratë për furnizim me energji elektrike për konsumatorët jo shtëpiak e datës 16.12.2013

Konsumatori "**K.M SH.P.K**" përmes komunikimeve elektronike ka parashtruar ankesë në DMK të ZRrE-së duke kërkuar shqyrtimin e kërkesës së tyre për ndërrim të grupit tarifor nga 7/2 në grupin 6/6, pasi konstaton se janë kryer edhe pagesat për PEE, por që kërkesa e tyre është refuzuar nga KESCO dhe KEDS.

Provë: Ankesë elektronike e datës 28.10.2021

Departamenti për mbrojtjen e konsumatorëve në ZRrE, pas marrjes së ankesës së konsumatorit, ka kërkuar nga KESCO sqarime shtesë në lidhje me arsyen e mos plotësimit të kushteve për ndërrimin e grupit tarifor për konsumatorin. Të njëjtit janë përgjigjur se konsumatori edhe pse është pajisur me PEE, ai asnjëherë nuk ka paraqitur kërkesë për Pranim Teknik, sipas së cilës kërkesë ekipet e OSSH-së do të mund të verifikonin nëse punët e kryera janë përfunduar sipas kërkesave të OSSH-së. Si rezultat dhe në mungesë të kryerjes së punimeve sipas PEE-së dhe pa posedim të raportit teknik pozitiv nuk mund të bëhet ndërrimi i grupit tarifor në sistemin e faturimit.

Provë: Komunikimet elektronike datë 20.12.2021; 16.02.2022

Bordi i ZRRE-së duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEDS/KESCO, ka vërejtur se:

Me datë 04.10.2018 konsumatori **K.M SH.P.K** bazuar në rregullat dhe procedurat në fuqi ka aplikuar në KEDS për rritje të fuqisë si dhe pëlqim të ri elektroenergjetik, po ashtu edhe ndërrimin e grupit tarifor të faturimit nga 7/02 në 6/6. Me datë 06.12.2018, bazuar në kërkesën e konsumatorit për rritje të fuqisë, KEDS ka lëshuar Pëlqim Elektroenergjetik për kompaninë **K.M SH.P.K** dhe ka caktuar kushtet energjetike dhe kushtet teknike dhe po ashtu ka caktuar afatin kohor brenda të cilit është i vlefshëm ky pëlqim elektroenergjetik. Sipas PEE nr. 13501 datë 06.12.2018, konsumatori TS e tanishëm Sn=160 kVA Koshare (Sharra) (bashkë pronar) duhet të zëvendësoj me transformatorë të ri Sn=250 kVA si dhe janë përshkruar kushtet e tjera teknike të cilat duhet të zbatohen. Bazuar në skemën një polëshe të dorëzuar se bashku me PEE nr. 13501 vërehet se konsumatori ka të instaluar TS me fuqi Sn=160 kVA

Me datë 28.12.2018, konsumatori **K.M SH.P.K** ka bere pagesën e Pëlqimit elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS me datë 06.12.2018 duke paguar për fuqinë e kërkuar në vlerë 1,775.78€ e ku përfshihet 97.66 kW*15€, shërbimi për kyçje në vlerë 40€ si dhe TVSH. Po të njëjtën ditë, konsumatori **K.M SH.P.K** parashtron kërkesë në KEDS, duke kërkuar revidimin e pëlqimit



elektroenergjetik me nr.13501 i datës 06.12.2018. Me anë të kësaj kërkesë kompania në fjalë kërkon nga KEDS që të merr shumë seriozisht ndërrimin e grupit tarifor, sepse me ligj nëse del që shpenzimet janë mbi 40-kVA, konstaton se KEDS janë të detyruar të bëjnë ndërrimin e grupit tarifor të cilën e ka përsëritur edhe me datë 04.01.2019. po ashtu në kërkesën e drejtuar KEDS-it për revidim të pëlqimit është evidentuar nga konsumatori se trafotja ekzistuese prej 250 kVA është vendosur nga KEK në vitin 2008 pas dëmtimit të trafos së vjetër prej 160 kVA. Me datë 27.05.2019 KEDS përmes një shkresë informon konsumatorin se lidhur me kërkesën e tij për revidimin e pëlqimit elektroenergjetik me nr. 13501 të datës 06.12.2018 në fsh.Koshare, KK-Shtime, KEDS ka shqyrtuar kërkesën e palës, e refuzon të njëjtin dhe njofton se mbetet në fuqi pëlqimi elektroenergjetik paraprak nr.13501 i datës 06.12.2018

Me datë 03.11.2020 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për kontrollimin e Grupeve matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të GM nr. 40239908 ku TL=23455.661 kWh dhe TU=2411,247 kWh dhe gjendja e njehsorit reaktiv TL=7946,380 kVAr dhe TU=167,510 kVAr, gjendja e maksigrafit TL=5,4058 si dhe konstanta C=40. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar po ashtu se behet ndërrimi i TMRR nga 100/5A në 200/5A andaj edhe ndërrohet konstantja nga C=20 në C=40 si dhe që duhet të behet ndërrimi i kategorisë së konsumatorit nga 7/02 në 6/6.

Bazuar në analizën e rrjedhës së energjisë elektrike si dhe transaksioneve vërtetohet se konsumatori i është ndërruar GT vetëm në një periudhë mujore dhe atë në periudhën 12/2020 e cila prapë është rikthyer në GT 7/02. Konsumatori ka parashtruar ankesa të shumta lidhur me faturimet e bëra para dhe pas kësaj periudhe duke kërkuar që të faturohet sipas kërkesës për ndërrim të grupit tariforë dhe procesverbalit nr.0210709 datë 03.11.2020 përkatësisht në GT 6/6. KESCO po thajse në të gjitha këto ankesa i ka kthyer përgjigje konsumatorit. Në përgjigjen e datës 28.05.2019 theksohet se: Sipas analizës së konsumit të përgatitur nga Komisioni për Korrigjime të Faturave nga KESCO, në bazë të ankesës së konsumatorit, bëhet analiza e rrjedhave energjetike marr nga AMR të konsumatori për vitet 2015, 2016, 2017, 2018 dhe pjesa deri 04/2019, ku konstatohet se njësia matëse ka funksionuar në rregull dhe të dhënat bazike janë reale të regjistruara sipas konsumit dhe kërkesave të konsumatorit "**K.M SH.P.K**". Sipas rrjedhave në CRMS shihet se konsumatori ka një konsum me rrjedhshmëri të ndryshme me rritje graduale nëpër vite si dhe është prezantuar përmes tabelës si dhe që konsumatori për vite ka rritur fuqinë e angazhuar në mënyrë rapide pa e njoftuar KEDS-in e që kjo është në kundërshtim me ligjet, rregullat dhe kodet teknike në fuqi. Me datë 27.10.2020 përmes postës elektronike KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke theksuar se : *Ashtu siç ju kemi njoftuar edhe përmes e-mailit të dërguar me dt. 21 Dhjetor 2018, në mënyrë që të procedojmë me tutje kërkesën tuaj për ndërrim të Grupit Tarifor ju fillimisht duhet të përfundoni punimet sipas Pëlqimit Elektroenergjetik nr.13501 dt.06.12.2018. Pas përfundimit të punëve teknike sipas këtij Pëlqimi Elektroenergjetik, ju duhet të aplikoni për Pranim Teknik që nënkupton rregullimin e çështjeve tekniko-energjetike, respektivisht zyrtarizmin e furnizimit dhe rregullimit të marrëdhënieve kontraktuale mes jush dhe ndërmarrjes së energjisë. Ju lutem na njoftoni nëse keni aplikuar për Pranim Teknik (na dërgoni dëshminë) në mënyrë që ta procedojmë lenden tuaj me tutje. Momentin që behet pranimi*



teknik nga ana e ekipeve te KEDS, do te pasoje edhe ndërrim grupit tarifor ne fjale. Per me tepër, bazuar ne te dhënat qe kemi ne dispozicion rezulton qe fuqia maksimale e angazhuar ne objektin tuaj ka tejkaluar fuqinë maksimale të angazhuar ndaj asaj të aprovuar nga ana e KEDS. Konsumi i energjisë elektrike nga ana juaj me fuqi maksimale më të madhe sesa ajo e aprovuar nga KEDS është duke shkaktuar shumë probleme në pajisjet tona elektrike duke përfshirë edhe pajisjet matëse si dhe pajisje tjera në rrjetin elektrik. Përveç kësaj, konsumatorët ekzistues janë duke pësuar nga furnizimi i dobët me energji elektrike për shkak të rënies së tensionit dhe për shkak të rrethanave të krijuara energjetike nga tejkalimi i fuqisë së angazhuar nga ana juaj. Per informimin tuja, përderisa punët teknike nuk përfundohen nga ana juaj dhe te njëjtat nuk janë pranuar teknikisht dhe zyrtarizuar nga ndërmarrja e energjisë, KEDS mban te drejtën e shkrycjes se pikës matëse tuajën bazuar ne rregullën per kushtet e përgjithshme per furnizim me energji elektrike 32.1.1 per shkak te shfrytëzimit te energjisë elektrike ne mënyrë te pakontraktuar.

ZRRE, pas marrjes së ankesës së konsumatorit, ka kërkuar nga KESCO sqarime shtesë në lidhje me arsyen e mos plotësimit të kushteve për ndërrimin e grupit tarifor për konsumatorin. ZRRE ka pranuar sqarimet si me poshtë: Në lidhje me rastin e **K.M SH.P.K**, sipas informatave të pranuar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, më lejoni të ju sqaroj në detale rrjedhën kronologjike të rastit dhe kushtet aktuale teknike me dokumente të cilat i kemi në dispozicion. Konsumatori ka bërë kërkesë për ndërrim të grupit tarifore nga 7/02 në 6/6 me datë 04.10.2018 dhe rritje të fuqisë ne 97.66kW. Në lidhje me këtë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka bërë inspektimet në teren dhe ka vërejtur se: Trafo stacioni, i cili në skemat e OSSH një polare figuron si trafo stacion 160 kVA, është aset privat dhe nuk është në përgjegjësi të OSSH-së për mirëmbajtjen e tyre. Ky transformator ka shërbyer vetëm për nevoja të pronareve (biznese dhe shtëpi) të këtij trafo stacioni, respektivisht për konsumatorin Dardania Model me konstantë të faturimit 30, pra përmes matjes gjysme drektë me TMRR 150/5, si dhe për 9 konsumatorë tjerë (familjare te tij), ku ndër ta edhe **K.M SH.P.K** (por jo me fuqi te cilën e ka kërkuar).

1. Transformatori i cili ka qenë në teren në datën e inspektimit ka qenë i fuqisë 250kVA. Sipas të dhënave të OSSH-së në listën e skemave një-poleshe figuron se është transformatori 160 kVA, që nënkupton se konsumatori ka bërë ndërrim të paautorizuar të transformatorit.
2. Sipas informatave nga OSSH, për transformatorin e vendosur në mënyrë të paautorizuar nga konsumatori nuk ka pranim teknik.
3. Lidhjet e tensionit të mesëm kanë qenë jashtë standardeve të lejuara (vazhdojnë të qëndrojnë ashtu) dhe janë të lidhura të gjitha (hyrja, dalja dhe trafo fusha) në një pike (kthinë të vetme) ndërsa duhet të jetë me 3 kthina të ndara.
4. Paneli i tensionit të ultë është jashtë standardeve të lejuara. Ky panel duhet të ndërrohet me një panel të ri i cili duhet të këtë ndërpresin kryesor, dy ndërpres për konsumatorët e grupit 6/6 (për **K.M SH.P.K** dhe Dardania model dhe një ndërpres për daljen 0.4 i cili furnizon konsumatorët shtëpiak).
5. Po ashtu edhe blinda do të duhet të rishqyrtohet nëse i plotëson kushtet për tu vendosur transformatori i ri prej 250 kVA, kthinat e reja dhe paneli i ri.
6. Marrë parasysh të gjitha këto të dhëna dhe kërkesën e konsumatorit, OSSH ka lëshuar Pëlqimin elektroenergjetik dt. 06.12.2018, të cilin e gjeni të bashkangjitur, në te cilën janë përkthuar në detale kushtet teknike të cilat duhet të plotësohen në mënyrë që të kemi një pranim teknik nga OSSH dhe përfundshmit të mundësohet edhe ndryshimi i grupit tarifore sipas kërkesës së konsumatorit. Po ashtu në këtë pëlqim është kërkuar



që për bizneset Dardania Model dhe K.M SH.P.K të kemi vetëm nga një pikë matëse dhe jo siç është për momentin i regjistruar me pika matëse për të njëjtin biznes dhe në njëjtin lokacion.

Bordi i ZRRE ka shqyrtuar me kujdes ne plotni gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga palët dhe konstaton se KEDS me rastin e lëshimit të Pëlqimit Elektroenergjetik nr.13501 dt.06.12.2018 ka vepruar konform kërkesës së konsumatorit për rritje të fuqisë përkatësisht konform nenit 9 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me energji e ku thuhet se: “Pas regjistrimit të aplikacionit për kyçje/modifikim të kyçjes ekzistuese, Operatori i Sistemit duhet të bëjë veprimet e nevojshme që të studioj kërkesat teknike të kyçjes, nëse është e nevojshme të vizitojë pronat që janë subjekt i aplikimit, dhe të hartojë dhe dërgoi ofertën për kyçje në formë të shkruar, në pajtim me metodologjinë e taksave për kyçje”, kurse sa i përket faturimit dhe ndërrimit të grupit tarifarë duke pasur parasysh edhe mos plotësimin e kushteve teknike nga ana e konsumatorit sipas Pëlqimit Elektroenergjetik nr.13501 dt.06.12.2018 konstatohet se KESCO ka vepruar konform nenit 5 paragrafi 1.5 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me energji e ku thuhet se: të gjithë konsumatorët kanë të drejtën dhe obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja.

Bordi i ZRRE-së duke pasur parasysh edhe skemat e OSSH një poleshe e ne te cilat figuron se konsumatori ka trafo stacion 160 kVA kurse me rastin e inspektimit, Transformatori i cili ka qenë në teren në datën e inspektimit ka qenë i fuqisë 250kVA konstaton se ndryshimi i aseteve dhe kyçjen në rrjetin elektrik pa lejen e KEDS është në kundërshtim me nenin 32 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me energji e ku thuhet se: Konsumatori do të konsiderohet se shfrytëzon energji në mënyrë të pa kontraktuar nëse shfrytëzon energji në një mënyrë ose në sasi që nuk është si ajo që i është miratuar nga ndërmarrja e energjisë. Konsumatori nuk ka ofruar asnjë dokument me të cilin do të vërtetohej se trafo me fuqi 250 kVA është vendosur në vitin 2008 nga KEK divizioni i rrjetit ashtu si ka evidentuar në ankesën e tij. Po ashtu konsumatori ka ofruar deklaratën e noterizuar me datë 15.11.2018 me të cilën vërteton se trafo e fuqisë 160 kVA me numër serik 19019 e vendosur në fshatin Koshare KK. Ferizaj në vitin 1982 është në bashkëpronësi 50% me 50% me z.Imri Sopaj dhe se edhe mirëmbajtja dhe shfrytëzimi është i përbashkët.

Bordi i ZRRE-së bazuar edhe në analizën e faturimit të konsumatorit konstaton se KESCO ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me energji e ku thuhet se: *1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme), 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit*



Bordi i ZRRE duke pasur parasysh te gjitha faktet e përmendura me lartë, dëshmitë dhe argumenteve të paraqitura nga palët e ne veçanti analizës së konsumit, kërkesës se konsumatorit per rritje te fuqisë dhe ndërrimit te GT, ndërrimit të paautorizuar të transformatorit, mos respektimin e Pëlqimit Elektroenergjetik nr.13501 dt.06.12.2018 të lëshuar nga KEDS sipas kërkesës per rritje te fuqisë, e të tjera shkresa, në mbledhjen e mbajtur me datë 29.07.2022 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit: **K.M SH.P.K**
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.